



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË
DEKLARATË**

Lidhur me mundësinë e rikthimit në sistem të prokurorëve, pas përfundimit të mandatit si Gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë duke ndjekur me vëmendje zhvillimet në vend dhe sidomos ecurinë e reformës në drejtësi, nisur nga:

- Shpallja e dy vendeve vakante për Gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese nga Presidenti i Republikës dhe nga Kuvendi;
- Roli kryesor që Gjykata Kushtetuese luan në garantimin e parimeve të ndarjes së pushteteve, ekuilibrin e pushteteve dhe sundimin e ligjit në Republikën e Shqipërisë
- Rekomandimet e Komisionit të Venecias në Opinionin e tij nr. 978/2020, i cili e konsideron si të një rëndësie jetike për funksionimin e Gjykatës Kushtetuese,

inkurajon prokurorët të cilët përmbushin kriteret për emërimin si Gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar duke u konfirmuar në detyrë, të aplikojnë për të ushtruar detyrën e Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në interpretim të nenit 18, pika 3 të Ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 (ndryshuar me ligjin nr.99/2016) “Për organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë” i cili shprehet: “Në përfundim të mandatit,, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese caktohet në një detyrë tjetër të barabartë ose të përafërt, të neneve 36 dhe 60, paragrafët 3 deri në 7 të Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji për Statusin), deklararon se dispozitat e sipërpërmendura përbëjnë një bazë ligjore të mjaftueshme për të garantuar prokurorët se nëse ata zgjidhen dhe ushtrojnë detyrën e Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, në përfundim të mandatit, Këshilli me kërkesë të tyre i rëmëron ata në sistem në një pozicion karriere.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETARI
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR
SANDËR BECI**

**ANËTAR
VATË STAKA**

**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**

**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**